

VENDIM
Nr. 467, datë 26.7.2023

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SHTETËRORE
PËR MBËSHTETJEN DHE ZHVILLIMIN E *STARTUP*-eve DHE LEHTËSUESVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 9/1, të ligjit nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve (këtu e në vijim, e njohur edhe si *Startup Albania*), si person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen, me seli në Tiranë.

2. *Startup Albania* financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme.

3. *Startup Albania* ka si mision të sigurojë mirëfunksionimin e ekosistemit të *startup*-eve në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet mbështetjes dhe zhvillimit të saj.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË *STARTUP ALBANIA*-s

Përgjegjësitë funksionale të *Startup Albania*-s, janë:

a) menaxhon dhe monitoron realizimin e masave mbështetëse financiare nëpërmjet fondeve publike ose të tretëve për nismat në ekosistemin e *startup*-eve në Republikën e Shqipërisë;

b) vetë ose, kur është rasti, në bashkëpunim me institucione të tjera publike ofron shërbimin *startup one stop-shop* për mbështetjen e *startup*-eve dhe lehtësuesve;

c) organizon punën për promovimin në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të nismave në ekosistemin e *startup*-eve të Republikës së Shqipërisë;

ç) organizon punën në cilësinë e organit mbështetës për *startup*-et dhe lehtësuesit, duke bashkëpunuar me palët e treta, me synim tërheqjen dhe mbështetjen e financimeve nga donatorë të huaj për ekosistemin e *startup*-eve në Shqipëri;

d) ndihmon ministrin përgjegjës për sipërmarrjen në ushtrimin e detyrave.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I *STARTUP ALBANIA*-s

1. *Startup Albania* e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror në nivelin e drejtorisë.

2. *Startup Albania* drejtohet nga drejtori, i cili është përfaqësuesi me të tretët.

3. Drejtori i *Startup Albania*-s emërohet, lirohet apo shkarkohet nga detyra nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen.

4. Drejtori i *Startup Albania*-s duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të ketë diplomë të nivelit “Master shkencor” apo “Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike”, ose të barasvlershme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë në shkenca sociale, inxhinierike, juridike, ekonomike apo të tjera, të lidhura me ekosistemin e *startup*-eve;

ç) të ketë përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet;

d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

e) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës.

5. Drejtori i *Startup Albania*-s lirohet nga detyra, kur:

a) plotëson kushtet për pensionin e plotë të pleqërisë;

b) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;

c) ristrukturohet institucioni;

- c) gjendet në një situatë konflikti të vazhdueshëm interesi;
- d) jep dorëheqjen nga detyra.
- 6. Drejtori i *Startup Albania-s* shkarkohet nga detyra kur:
 - a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
 - b) kryen shkelje të rënda gjatë detyrës;
 - c) nuk përmbush objektivat strategjikë të institucionit.
- 7. Marrëdhëniet e punës së drejtorit, të nëpunësve dhe punonjësve administrativë të *Startup Albania-s* rregullohen në bazë të Kodit të Punës.
- 8. Struktura dhe organika e *Startup Albania-s* miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
- 9. Institucionet e tjera që mbështesin me masa mbështetëse inovacionin, teknologjinë e informacionit dhe digjitalizimin, sipas kërkesës, i përcjellin informacion *Startup Albania-s* për subjektet e mbështetura në funksion të koordinimit në tërësi.
- 10. *Startup Albania*, në përputhje me përgjegjësitë e veta, kryen këto detyra:
 - a) administron “Regjistrin e *startup*-eve dhe lehtësuesve” dhe në bashkëpunim me AKSHI-n ndjek mirëfunksionimin e aplikimeve për pasaportat e *startup*-eve dhe lehtësuesve;
 - b) asiston subjektet e interesuara përgjatë procesit të aplikimit për pasaportën e *startup*-it;
 - c) përgatit dhe publikon raportin vjetor për ecurinë e funksionimit të “Regjistrin të *startup*-eve dhe lehtësuesve”;
 - c) informon subjektet për mundësitë e mbështetjes qeveritare apo për skemat e mbështetjes në ekosistemin e *startup*-eve;
 - d) administron dhe përditëson portalin elektronik zyrtar startupalbania.gov.al;
 - dh) si sekretariat teknik asiston dhe informon Këshillin e *Startup*-eve me kërkesë të kryetarit të Këshillit për tematika të nevojshme dhe në kuadër të hartimit të dokumenteve strategjike;
 - e) shërben si sekretariat teknik për komisionet që ngrihen në funksion të vlerësimit të kërkesave dhe ankesave për masat mbështetëse për nismat në ekosistemin e *startup*-eve;
 - ë) lidh marrëveshje dhe monitoron zbatimin e tyre me përfituesit e granteve financiare, programeve dhe masave mbështetëse sipas legjislacionit në fuqi;
 - f) shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin justifikues dhe financiar në funksion të ecurisë së zbatimit të masave mbështetëse;
 - g) kryen disbursimin e fondit për realizimin e projekteve sipas legjislacionit përkatës;
 - gj) në raste abuzimi ose mospërmbushje detyrimesh të parashikuara në marrëveshje, ndërmerr veprimet ligjore për rikthimin e fondit të disbursuar;
 - h) i propozon ministrit përgjegjës për sipërmarrjen nevojat për masat mbështetëse për ekosistemin e *startup*-eve në kuadër të planifikimit për vitin pasardhës;
 - i) përgatit dhe publikon raportin vjetor dhe raporte të tjera periodike sipas kërkesës për ecurinë e ekosistemit vendas të *startup*-eve në Republikën e Shqipërisë dhe për performancën e këtij ekosistemi në nivel ndërkombëtar;
 - j) përgatit raporte dhe informacion përmbledhës për çështje specifike të ekosistemit, në varësi të problematikave të evidentuara dhe me kërkesë të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen;
 - k) mbledh, përpunon dhe analizon informacionin për kushtet, nevojat, kapacitetet e *startup*-eve dhe lehtësuesve, si dhe dinamikat e tendencat e tregut e të ekosistemit të *startup*-eve;
 - l) bashkëpunon me organizmat homologë, organizata dhe subjekte ndërkombëtare që veprojnë në fushën e nxitjes së *startup*-eve, për lehtësimin e aksesit të *startup*-eve vendase në tregjet ndërkombëtare dhe përfshirjen e tyre në programet ndërkombëtare të asistencës që ato ofrojnë;
 - ll) bashkëpunon me institucionet publike dhe organizatat joqeveritare, vendase dhe të huaja, që me veprimtarinë e tyre ndikojnë në ecurinë e ekosistemit të *startup*-eve të Republikës së Shqipërisë;
 - m) angazhohet në hartimin dhe përgatitjen e aplikimeve, si dhe përthithjen e fondeve me qëllim zhvillimin e ekosistemit vendas të *startup*-eve;

n) organizon dhe promovon evente specifike, të fokusuara te shkëmbimi i eksperiencave, këshillimi, mentorimi dhe rrjetëzimi për zhvillimin e ekosistemit të *startup*-eve;

nj) favorizon bashkëpunimin e aktorëve të ekosistemit të *startup*-eve me organet publike, përfaqësuesit e biznesit dhe botën akademike, si dhe palë të treta të tjera, me qëllim krijimin e një kuadri rregullator dhe institucional të favorshëm dhe krijimin e një tregu funksional për *startup*-et.

11. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të *Startup Albania-s* miratohet nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen.

12. *Startup Albania* ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema e *Startup Albania-s* përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, *Startup Albania*”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

13. Vula e *Startup Albania-s* ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vulat prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Drejtori i *Startup Albania-s* emërohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Deri në plotësimin e strukturës së *Startup Albania-s* dhe në caktimin e selisë së saj, drejtori do të mbështetet në detyrat e tij nga kabineti i ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.

3. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, *Startup Albania* kryen monitorimin dhe ndjekjen e detyrimeve ligjore edhe për përfituesit e masave mbështetëse të thirrjes së parë të vitit 2022.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku